



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:233166

Datë: 03.09.2024

Numri i dokumentit: 06117900

C.nr.563/2019

### PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 03.09.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit - Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.G. kundër të paditurit E.H. , me objekt kontesti rimbursim dëmi.

P r e z e n t:

Gjyqtari:  
Leotrim Gashi

Për paditësen  
B.G. sipas autorizimit

Për të paditurin:  
E.H.

Zyrtare ligjore  
Liridona Bajrami

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj në ora: 15:00.

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesja e autorizuar e paditëses dhe i padituri E.H. i sjellur nga Njësi për Transportin e të Paraburgosurve, për shkak se i padituri gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

## A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Pasi që më parë ka qenë e mundur që të paditurit t'i dorëzohet padia dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe pasi që në këtë seancë i padituri është ftuar përmes Qendrës së Komunikimit të Njësitit për Transportin e të Paraburgosurve, padia dhe shkresat e tjera të lëndës, i dorëzohen në këtë seancë dhe i jepet kohë që t'i lexojë dhe ta kuptoj objektin e kësaj çështje kontestimore.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit përfaqësuesja e paditësit, deklaron:

Duke marrë parasysh gjendjen familjare dhe financiare të të paditurit, propozojmë që këtë çështje ta mbyllim me marrëveshje gjyqësore, duke i mundësuar të njëjtit, pagesën e shumës prej 502 euro për dëmin material në veturë, në 25 këste mujore, ashtu që në muajin (këstin) e parë të paguajë shumën prej 22 euro, kurse në 24 muajt e tjerë shumën prej 20 euro në muaj

duke filluar nga data 01 deri në 10 të çdo muaji vijues dhe atë nga muaji tetor 2024 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Heqim dorë nga shpenzimet e procedurës dhe nga kamata ligjore.

I padituri deklaron se pajtohet me këtë propozim të përfaqësueses së paditëses.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

### PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHET i padituri E.H. në emër të shkaktimit të dëmit, në aksidentin e datës 11.10.2017, për dëmin material të veturës së të dëmtuarit B.B. , t'ia paguajë paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit shumë prej 502 euro, në 25 këste mujore, ashtu që në muajin (këstin) e parë të paguajë shumë prej 22 euro, kurse në 24 muajt e tjerë shumë prej 20 euro në muaj, duke filluar nga data 01 deri në 10 të çdo muaji vijues dhe atë nga muaji tetor 2024 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, e cila shumë duhet të paguhet në xhironlogarinë e paditëses me numër --- në Bankën...
- II. Paditësja heq dorë nga shpenzimet e procedurës dhe nga kamata ligjore.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

### A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora 15:20 minuta.

Përfaqësuesja e paditëses

I padituri

V e r t e t o j n e

Numri i lëndës: 2019:233166  
Datë: 03.09.2024  
Numri i dokumentit: 06117900

Zyrtarja ligjore

Gjyqtari